



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Data \_\_. \_\_. 2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “ Karburant për Ndërmarrjen e Shërbimeve Komunale ”;**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Karburante-0910000-0, karburante diesel-09134100-8**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 2 177 588(dy milionë e njëqindë e shtatëdhjetë e shtatë mijë e pesëqindë e tetëdhjetë e tetë)lekë pa tvsh.**

**Argumentimi i fondit limit:** Komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit i është referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); konkretisht KLLFLST ka mar si referenc të cmimit të karburantit cmimin e publikuar ne buletinin e prokurimit nr 17,datë 02.04.2024dhe kurs kembimi I dollarit eshte ai I dates 04.04.2024 të bankes së Shqipërisë,dokumentuar kjo me relacionin nr.2397/2 date 05.04.2024.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik””, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Roskovec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

Këto kritere janë vendosur për të vërtetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte. Gjithashtu këto kritere janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjesinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

a. *Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme, sipas shtojcës 7 dhe 8.*

b. *Të paraqitet leja përkatëse për lejimin e tregtimit të karburanteve sipas objektit të prokurimit.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 14, pika 2, dhe 77, pika 1/a dhe 2, të LPP”, i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Mbështetur në ligjin 8450 datë 24/02/1999 “Per perpunimin, transportimin e naftes dhe nenprodukteve të tjera” me ndryshimet përkatëse. *Keto kriter vendoset për të vërtetuar që operatori ekonomik pjesmarrës ka eksperiencën e duhur dhe kapacitetin potencial ekonomik.*

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për*

vitet financiare 2022-2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës e përkatësisht: 850 000 lekë pa tvsh.

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik", si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke patur në konsideratë vlerën e objektit të prokurimit«:**Karburant për Bashkin Roskovec**»,pika 3 e nenit 77 të LPP dhe sipas parashikimeve në nenin 43, pika 1 dhe 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku parashikohet se: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar..", si dhe mbi bazën e nenit 29, të ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.", si pika 1 dhe 2/c, në zbatim të nenit 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe nenit neni 41, gërma "c" të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM "Për rregullat e prokurimit publik", e cila parashikon se Autoriteti koonraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Konraktor.

**2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2023 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c,**

sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2023.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”,; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia ROSKOVEC, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

### **2.3.1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 400 000 lekë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”,” dhe në nenin 55, pika 4/ b e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

***Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*** Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se furnizimet e mëparshme të ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (pika a dhe b të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e shërbimeve publike/private të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

**2.3.2.**Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001-2015 ose ekuivalente **te vlefshëm** që i referohet objektit të prokurimit.

***Çertifikatat të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.***

***Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes.***

**Argumentimi ligjor dhe i AK :** Referuar nenit 40 pika 6/c, dhe 44 pika 1 të VKM 285 date 19.05.2021. Ky certifikim tashme nje standart gjeresisht i kerkuar ne fushen e prokurimeve publike, i mundeson AK per te verifikuar dhe krijuar besimin qe OE ofertues eshte ne gjendje te realizoje kontraten ne menyre cilesore . Ky kriter e siguron AK se OE qe do te shpallet fituese eshte e certifikuar sipas ketij standarti , rezulton nje kompani serioze e certifikuar ne menaxhimin e cilesise.

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të jetë i pajisur me Licencë të tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) ose Autorizim për ushtrim aktiviteti “Tregti me pakice të lendeve djegese Karburante.

**Argumentim :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”; dhe ***në zbatim të nenit 40, pika 5, gërma “a” e VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pikës 2 dhe 3 të nenit 20 Ligjit Nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin e naftës dhe nënprodukteve të tjera” i ndryshuar, VKM – së Nr. 538, datë 26.05.2009 “Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.***

*Dhënia e licencës për tregtim me pakicë së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikantë dhe të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë si dhe për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, bëhet nga organet e qeverisjes vendore.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI (Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial), që subjekti ofertues ka importuar ose tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar, dhe nuk ka pasur penalitete për shkelje të cilesive për vitin e fundit.

**Argumentimi ligjor dhe i AK :** Kjo kerkese eshte nje paresore per AK si kriter i vecante i cilesise se mallrave qe prokurohen dhe affidabilitetit te Furnizuesit ne marredheniet kontraktuale per kete objekt prokurimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik, i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”;;” nenit 40, pika 6, gërma c, dhe neni 44 të VKM nr.285, date 19.05.2021 “Për miratimin e Regullave të Prokurimit Publik”.

Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton Ligji nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, I ndryshuar, Vkm nr.147 date 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, Vkm nr.970 datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj “ I ndryshuar , ligjin nr.10433 datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” , Vendimit nr.429, datë 26.6.2019 për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta , për përdorim termik , civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor(detar, lumor,liqenor)”, Udhër Nr.6 datë 09.01.2015 “Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe Nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifrat përkatëse, Urdhërit nr.315, datë 24.08.2017”Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitete ë fushën e përpunimit, transportimi dhe tregëtimin të naftës dhe nënprodukteve të saj.

Plotesimi i këtij kriteri garanton zbatimin e kontratës gjatë periudhës së zbatimit duke treguar që OE ofertues në aktivitetin e tij periodik zbaton rregullat dhe ligjet në fuqi.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë edhe deklaratat si më poshtë:

a) Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin me karburant, me pakicë, me shërbim 24 orë, për të gjitha mjetet e Bashkise Roskovec, me kartë elektronike të personalizuar, me targën e çdo automjeti dhe motorri të autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.



b) Operatori ekonomik duhet të deklarojë, se do të mbulojë furnizimin me karburant, nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar, për të gjithë sasinë e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

c) Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër që të furnizojë të gjithë sasinë e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targën e mjetit, si dhe pjesën e kërkuar nëpërmjet leshimit të tollonave, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor. Kartat elektronike dhe tollonat, duhet të jenë pa skadencë dhe të jenë të përdorshme deri në përfundimin e levrimit të gjithë mallit përcaktuar në shtojcën 6.

d) Operatorët ekonomike pjesëmarrës, duhet të deklarojnë se ofrojnë një ndërfaqe menaxhimi të karburanteve (Web-page), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit, të kryhet nëpërmjet kartës elektronike. Kjo ndërfaqe e menaxhimit të karburanteve (Web-page), duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori Ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, dhe nga llogarija elektronike e AK në mjetet e transportit, me qëllim rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti Kontraktor. Ndërfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit të disa raporteve, të cilat do të ndihmojnë AK për marrjen e vendimeve operacionale.

dh) Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ofrojë furnizimin me karburant me karta elektronike, të cilat duhet të jenë pa skadencë dhe të jenë të përdorshme dhe gjatë periudhës së zbatimit të kontratës, me Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr.561 datë 29.07.2016 ***“Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së përgjithshme”***.

**Argumentim :** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika , gërma ç,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar në VKM Nr 561 datë 29.07.2016 ***“Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së përgjithshme”***

**Argumentimi i AK** për pikat 2.3.5 – a,b,c,d,dh : Vetëdeklarimet e mësipërme ( si dhe procedura e demonstrimit) kerkohen nga AK si garanci që furnizimi do të realizohet me karta elektronike.

### **2.3.6 .Të paraqiten**

**Aktiviteti i vëmprimitarise për pikën e karburantit duhet të jetë në një distancë jo më të largët se 20 km nga vendndodhja e objektit të prokurimit** vertetur kjo me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate qiraje noteriale/ akt pronësie) **OSE duhet të paraqes një kontrat noteriale furnizimi me karburant të lidhur me një nga subjektet që disponojnë pik karburanti që ushtrojnë aktivitetin brenda territorit të Bashkisë Roskovec.**

*Argumentim : Ky kriter është vendosur duke u bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 5, e VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe duke marrë parasysh gjithashtu edhe mjetet e rënda teknologjike të cilat nuk mund të përshkojnë distanca të largëta rruge pra ky kriter vendoset me qëllim për ti favorizuar mjetet e rënda teknologjike si dhe mjetet e bashkisë të mos nevojitet të përshkojnë distanca të largëta rruge jashtë territorit të Bashkisë pasi do kemi kosto karburanti nese mjetet e bashkis do te furnizohen ne nje pik karburanti me distanc të larget nga Bashkia .*

2.3.7- Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6 të këtij neni ku parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.*

*Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

*Argumentimi :Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 26, pika 1 e VKM-së, nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .*

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.**

**Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

\*\*\*

U ra dakort nga antaret e Njesisë se Prokurimit te ngritur me urdher te titullarit te autoritetit kontraktor,**nr.UP.37,datë.12.04.2024**, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është:**“ Karburant për Ndërmarrjen e Shërbimeve Komunale ”,me fond limit: 2 177 588(dy milionë e njëqindë e shtatëdhjetë e shtatë mijë e pesëqindë e tetëdhjetë e tetë)lekë pa tvsh,,lloji i procedures:E hapur e thjeshtuar.**



Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës .

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

***KLLFLST nuk ka paraqitur specifikime teknike per kete objekt prokurimi.***

Anëtarët pranuan procesverbalin dhe preventivin të hartuara nga Komisioni i posaçëm :**KLLFLST( Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike)** i ngritur me urdhër të titullarit të Autoritetit Kontrakt **nr.2397prot,datë 03.04.2024**,duke konsideruar se ato shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për mallin që do të blejë.

**Argumentimi:Preventivat jane hartuar nga specialistet e fushes konkretishtë nga KLLFLST,dorëzuar preventivat me procesverbalet e komisionit nr. nr.2397/1prot,datë05.04.2024dhe shprehin qarte kerkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha mallrave Komisioni për hartimin e preventivit është bazuar në cmimin e karburantit e publikuar ne buletin e prokurimit nr 17,datë 02.04.2024,dokumentuar kjo me relacionin nr.2397/2 date 05.04.2024.**

**PREVENTIVAT “ Karburant për Ndërmarrjen e Shërbimeve Komunale ”;**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

<b>NR</b>	<b>EMERTIMI</b>	<b>NJ.MATJES</b>	<b>SASI</b>
<b><u>1</u></b>	Nafte D2	litra	<b>14 531</b>
<b><u>2</u></b>	Benzin	litra	<b>200</b>

**Afatet e lëvrim:**

**Lëvrimi i mallit do të bëhet sipas nevojave dhe kërkesave të Autoritetit Kontraktor nga data e nënshkrimit të kontratës, brenda 12(dymbëdhjetë) muaj.**

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do ti paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për tu firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

**NJËSIA E PROKURIMIT:**